



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	02/08/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z.Afrim Bajraktari Drejtor i Prokurimit në Universitetin e Prishtinës
CC:	z.Esat Kelmendi Sekretar i përgjithshëm i UP-së
NGA/OD/FROM:	z.Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandim për Tenderin "Pastrimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të Universitetit të Prishtinës"

Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Pastrimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të Universitetit të Prishtinës" me nr: të prokurimit: 90400-13-050-211, Agjencia kundër Korrupsionit ka arritur në këtë:

OPINION

Agjencia Kundër Korrupsionit, gjatë procesit të vëzhgimit në vlerësimin e Tenderit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" në Njoftimin për Kontratë "Pastrimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të Universitetit të Prishtinës" me nr: të prokurimit: 90400-13-050-211 ka arritur në përfundim se janë bërë disa favorizime për Operator të caktuar Ekonomik në të njëjtën kohë janë diskriminuar disa të tjerë.

ARSYETIM

Më datë 15.07.2013 është emëruar komisioni për vlerësimin e ofertave për Tenderin: “Pastrimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të Universitetit të Prishtinës” me nr: të prokurimit: 90400-13-050-211. në përbërje prej tre anëtarëve (Naser SAHITI, Jonuz DERVODELI dhe Heset ÇAKOLLI). Gjatë punës së komisionit për vlerësimin e ofertave dhe prezencës së përfaqësuesve të Agjencisë Kundër Korrupsionit në cilësinë e vëzhguesit, komisioni në mënyrë unanime ka rekomanduar anulimin e tenderit për arsye se nuk janë plotësuar kushtet administrative.

Gjithashtu në të njëjtin “Njoftim Kontrate” të publikuar në KRPP më datë 12/06/2013, tek pika III.2.3 e rubrikës “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 1 ku kërkohet: Qarkullimi në tre vitet e fundit në shumën prej 2.000.000.00 në lëmin e pastrimit (të objekteve), dëshmia e kërkuar financiare: 1) Kontrata në lëmin e pastrimit (të dëshmohet qarkullimi 2.000.000.00). nuk është në përputhshmëri me nenin 68 të ligjit të Prokurimit me Nr.04/L-042.

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Pastrimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të Universitetit të Prishtinës” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

Po ashtu ne si AKK rekomandojmë që në “Dosjet e Tenderit” dhe në “Njoftimin për Kontratë” të inkorporohet paragrafi: “Operatorët Ekonomikë që kanë kontrata me Universitetin e Prishtinës e të cilët nuk i kanë realizuar sipas dinamikës së paraparë deri në ditën e ofertimit për këtë tender nuk shpërblehen edhe nëse i plotësojnë kriteret tjera dhe po ashtu nuk do të trajtohen si tender të përgjegjshëm as tenderët e OE që kanë realizuar projektet e tyre me vonesa të pa arsyeshme dhe të atyre që për fajin e tyre u janë ndërprerë kontratat” në mënyrë që Operatorët Ekonomik të pa përgjegjshëm paraprakisht, të ndëshkohen si pasojë e papërgjegjësi të veta paraprake.

Me respekt!